



Pranuar / Dorezuar Prilazheni/Prilazha Received/Delivered	07-04-2022	2 viti god year
Organ dhe shtesa Organ/Dodimica Org./Addit.	1954/2022	Sasia Kolicina Quantity
Hi/Prot Br/Prot Prot.No	SKMP/SHCK	115
Shtesa Prilog Appendix		



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.244/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.244/2022 të datës 17.03.2022 të parashtruar nga _____ me adresë banimi: _____ në Prishtinë, kundër Njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 10.03.2022 për pozitën Zëvendës Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike të datës 10.03.2022, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET poshtë si e pajtuar ankesa A.nr.244/2022 e datës 17.03.2021 e parashtruar nga ankuesi _____

A r s y e t i m

Ankuesi, përmes e-mailit ankesa.kpmshek@rks-gov.net më datë 17.03.2022, ka parashtruar ankesë me Nr.Prot:1419/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 10.03.2022 për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike, me pretendimet për shkelje ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.03.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Ndërsa Këshilli, me datë 01.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e palejuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 21.01.2022 ka shpallur konkursin për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike, në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, i cili është përfshirë në fazat e konkurrimit respektivisht është ftuar në intervistë me gojë.

Pas përfundimit të procedurës së rekrutimit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve më datë 10.03.2022 ka publikuar njoftimin për kandidatin e suksesshëm për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike, në bazë të cilit ankuesi nuk ka rezultuar si kandidat i suksesshëm.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 10.03.2022 për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike, përveç pretendimeve ankimore që ka pasuar shkelje procedurale në këtë proces, thekson edhe pse në njoftimin për kandidatin e suksesshëm është dhënë mundësia për ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve edhe Ankesave në Sekretariatën e KQZ-së, nuk ka parashtruar ankesë sepse ky komision në dy rast të njëjta në vitin 2013 dhe 2019 është shpall jo kompetent për të vendosur për pozitën e larta drejtuese.

Lidhur me këtë konstatim, në kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 23.03.2022, kemi kërkuar dëshmi nëse ankuesi ka parashtruar ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, mirëpo në bazë të përgjigjes në ankesë të datës 01.04.2022 nuk ka asnjë dëshmi që ankuesi kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 10.03.2022 për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike të ketë parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje juridike, i është referuar Aktgjyqimit në rastin nr. KO203/19 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetues të Republikës së Kosovës, lidhur me Vlerësim i kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili në nenin 207 parasheh që: *“Institucionet e Pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj Personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për aq sa ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre”,* në këtë rast për nëpunësit civil të Institucioneve të Pavarura Kushtetues aplikohen dispozitat e akteve të brendshme të institucioneve dhe dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës për aq sa nuk cenohet pavarësia e tyre. Duke marr parasysh këtë fakt Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vlerëson se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është institucion i pavarur kushtetues i paraparë me Kapitullin XII respektivisht nenin 139 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, rrjedhimisht për nëpunësit civil të këtij institucioni aplikohen rregullat e brendshme të këtij institucioni dhe dispozitat e legjislacionit për shërbimin civil përderisa nuk cenohet pavarësia e tij.

Bazuar në njoftimin për kandidatin e suksesshëm të datës 10.03.2022 për pozitën Zëvendës Kryeshef Ekzekutiv në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, është përcaktuar që: *“Duke u bazuar në nenin 49 pika 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit në Sekretariatën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ju njoftoj se një nëpunës ose kandidat në një procedurë të rekrutimit është i pasuksesshëm dhe nuk emërohet në pozitën përkatëse dhe ai/ajo mendon se emërimi i një pësoni tjetër në atë pozitë, nuk është bërë në bazë të meritës ose është bërë si pasojë e parregullsiye në zbatimin e*



rregullave dhe procedurave, ai/ajo mund të ankohet me shkrim në Komisionin e Ankesave të Sekretariatit të KQZ-së, i cili shqyrton dhe vendos për ankesën brenda 30 ditëve nga data në të cili vendimi për përzgjedhje dhe emërim shpallet për kandidati nga institucioni përkatës”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve lidhur me procedurat e rekrutimit, ka miratuar rregullore të veçantë, ku neni 49 paragrafi 1 i Rregullores Nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka pacaktuar që: *“Kur një nëpunës ose kandidat, ne një procedure te rekrutimit është i pasuksesshëm dhe nuk emërohet ne pozitën përkatëse dhe ai/ajo mendon se emërimi i një personi tjetër ne atë pozite nuk është bare ne baze te meritës ose është bare si pasoje e parregullsive ne zbatimin e rregullave dhe proceduarve, ai/ajo mund te ankohet me shkrim ne Komisionin e Ankesave te Sekretariatit, i cili e shqyrton dhe vendos për ankesën”,* ndërsa paragrafi 2 i këtij neni, ka pacaktuar që: *“Ankesat duhet te dorëzohen brenda 30 ditëve nga data ne te cilën vendimi për përzgjedhje dhe emërim shpallet nga institucioni përkatës”,* mbi bazë të kësaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se nëpunësit civil apo kandidatët për pranim në shërbimin civil në kuadër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve fillimisht duhet të parashtrojnë ankesë konform dispozitave të lartcekura, këtë e ka paraparë edhe Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative konkretisht neni 128 paragrafi 1, i cili përcakton se: *“Nëse nuk parashikohet ndryshe me ligj, një ankesë kundër një akti administrativ mund t’i drejtohet organit publik që ka nxjerrë apo ka kompetencë të nxjerrë aktin (në tekstin në vijim: organi kompetent), apo organit publik mbikëqyrës të organit kompetent, apo një organi tjetër publik të përcaktuar shprehimisht me ligj (në vijim të dy këta të fundit: “organi epror”). Nëse ankesa i është drejtuar organit epror, ai ia përcjell, pa vonesë, organit kompetent”.*

Bazuar në dëshmitë e ofruara nga ankuesi si dhe dëshmitë e ofruara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me përgjigjen në ankesë, konstatohet që ankuesi kundër njoftimit për kandidatin e suksesshëm të datës 10.03.2022 për pozitën Drejtor Ekzekutiv i Zyrës për Regjistrim dhe Certifikim të Partive Politike nuk ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ashtu siç parashihet në nenin 49 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 03/2017 për Procedurat e Rekrutimit, Emërimit dhe Punës Provuese të Nëpunësve në Sekretariatit e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rrjedhimisht ankuesi fillimisht është dashur të parashtrojë ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pa supozuar vendimarrjen e komisionit, e pastaj varësisht nga vendimarrja e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në pajtim me nenin 127 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative, ka pasur të drejtë që të parashtrojë ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se nëpunësve civil të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil në këtë institucion, nuk i lejohet të parashtrojnë ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës pa i shterur procedurat e brendshme të ankimimit, mbi këtë bazë ankesa e ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është në kundërshtim me nenin 16 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili përcakton se: *“Para parashtrimt të ankesës në Këshill, nëpunësi civil apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar, duhet t’i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave brenda organit përkatës të punësimit, nëse me ligj të veçantë nuk është përcaktuar ndryshe”,* dhe si e tillë është e papranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët në procedurë, duke u bazuar në

kompetencën e Këshillit të përcaktuara në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.244/2022

Flakron GASHI


Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryeshefit Ekzekutiv të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së

